SYLLABYSET E MODULEVE TË PROGRAMIT

BACHELOR NË INXHINIERI NAVALE

SYLLABUS MAT 154 Kalkulus 1

Pedagogu: Doktorant . Arben Baushi

Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex/2sem

Kredite: 8

Objektivat e lëndës:
Programi synon të japë një studim të plotë të funksionit duke trajtuar bashkësinë e tij të përcaktimit, çiftësinë, monotoninë dhe ekstremumet duke vazhduar më tej me limitin e funksionit, vazhdueshmërinë e tij, diferencimin dhe integrimin e funksionit të një variabli, rregullat e derivimit dhe aplikime të derivatit, format e pacaktuara dhe rregulli I l'Hopital-it,etj.

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

1. Funksionet dhe modelet matematike.Ekuacionet jo-lineare. Funksionet monotone, funksionet rritës dhe funksionet zbritës. Diferencimi. Disa klasa të rëndësishme funksionesh.
2. Transformimet dhe kombinimet e funksioneve. Funksionet inverse. Përsëritje.
3. Problemi i tangjentes dhe shpejtësisë. Limiti i funksionit. Limitet e njëanshme dhe limitet e pafundëm.
4. Përkufizimi i saktë i limitit. Rregullat e kalimit në limit. Përsëritje
5. Vazhdushmëria. Limitet në pikat e pafundme. Tangentet, shpejtësitë, dhe raportet e tjera të ndryshimit.
6. Përkufizimi i derivatit. **PROVIMI I.** Interpretimi i derivatit si raport ndryshimi .
7. Derivati i një funksioni. Derivatet e funksioneve elementare. Funksionet exponenciale.
8. Rregulla të tjera të derivimit. Derivimi i funksioneve trigonometrike. Derivimi i funksionit të përbërë, rregulli zinxhir.
9. Derivimi në mënyrë implicite. Derivatet e rendeve të larta. Përafrimet Lineare dhe diferencialet.
10. Vlerat maksimum dhe minimum. Teorema e vlerës së mesme. **PROVIMI II**
11. Përcaktimi i grafikut nëpërmjet derivatit. Format e pacaktuara, rregulli i L'Hopital-it. Studimi i plotë i një funksioni nëpërmjet derivateve.
12. Problemet e optimizimit. Metoda e përafrimit e Njutonit. Antiderivatet
13. Sipërfaqet dhe distancat. Integrali i caktuar. Teorema themelore e kalkulusit.
14. Integralet e pacaktuara. Përsëritje. Metoda e zëvendësimit.
15. Logaritmi i përcaktuar si integral. **PROVIMI III**

Tema II: Temat qe do trajtohen ne seminare:

1. Funksionet . Funksionet monotone, rritës dhe funksionet zbritës. Ekuacionet jo-lineare. Disa klasa të rëndësishme funksionesh.
2. Transformimet dhe kombinimet e funksioneve. Diferencimi. Funksionet inverse
3. Problemi i tangjentes dhe shpejtësisë. Limiti i funksionit. Limitet e njëanshme dhe limitet e pafundëm
4. Përkufizimi i saktë i limitit. Rregullat e kalimit në limit. Vazhdushmëria
5. Limitet në pikat e pafundme. Tangentet, shpejtësitë dhe raportet e tjera të ndryshimit. Përkufizimi i derivatit. Interpretimi i derivatit si raport ndryshimi. Derivati si një funksion.
6. Derivatet e funksioneve elementare. Funksionet eksponencial. Rregulla të tjera të derivimit
7. Përsëritje. Derivimi i funksioneve trigonometrike.
8. Derivimi i funksionit të përbërë, rregulli zinxhir. Derivimi në mënyrë implicite
9. Derivatet e rendeve të larta. Diferencialet. Vlerat maksimum dhe minimum. Teorema e vlerës së mesme
10. Përcaktimi i grafikut nëpërmjet derivatit. Format e pacaktuara, rregulli i L'Hopital-it
11. Studimi i plotë i një funksioni nëpërmjet derivateve. Përsëritje
12. Problemet e optimizimit. Metoda e përafrimit të Njutonit. Antiderivatet

13. Sipërfaqet dhe distancat. Integrali i caktuar
14. Teorema themelore e kalkulusit. Integralet e pacaktuara. Metoda e zëvendësimit
15. Logaritmi i përcaktuar si integral. Përsëritje

Literatura baze dhe ndihmese:

- Kalkulus, T. Shaska, N. Pjerro
- Calculus, James Stewart (botimi i gjashte)

FORMAT E VLERESIMIT TE STUDENTEVE:

Kontrolli	**Vleresimi ne perqindje**
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35%

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 40-100%

Studenti, që rezulton me pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhe për të cilën do të testohet, nuk do te futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do te ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:

N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin “MAT 154”.

Telefonatat në numrin personal fiks apo cellular te pedagogut te lendes nuk janë të përshtatëshme: do t’ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t’ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin “MAT 154” Urgjent” n.q.s problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentet jane te lutur te mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: MAT 154. Përpara se studentet të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentet jane te lutur te mos drejtojnë nërpermjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla eshte mire tu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do te kete detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:

Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe pirja e duhanit në auditor.

SYLLABUS MAT 155 Kalkulus 2

Pedagogu: MSc. Anila Duka

Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex/2sem

Kredite: 8

Objektivat e lëndës:
Trajtimi i njohurive bazë të analizes matematike, do të bëhet një studim i plotë i teknikave të integrimit, aplikimeve të integraleve, koordinatave polare, numrat kompleksë, seritë numerike dhe polinomiale dhe zbërthimet e funksioneve në seri polinomiale

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

- Sipërfaqet midis vijave. Vellimet e trupave. Vëllimi nëpërmjet tubave cilindrike. Puna, mesatarja.
- Integrimi me pjesë. Integralet trigonometrike. Zëvendësimet trigonometrike. Integrimi i funksioneve racionale me thyesa te pjesshme.
- Integralet jo të mirefillta. Gjatësia e harkut. Sipërfaqet e rrotullimit.
- Vijat e përcaktuara nga ekuacionet parametrike. Kalkulus me vijat parametrike.
- Numrat kompleks.
- Koordinatat polare. Sipërfaqet dhe gjatësitë në koordinata polare.
- Prerjet konike. Prerjet konike në koordinata polare.
- Vargjet dhe seritë.
- Testi i integralit dhe parashikimi i shumave të serive.
- Kriteri i krahasimit. Seritë alternative.
- Konvergjenca absolute, testi i raportit dhe testi i rrënjës.
- Strategji për kriteret e serive.
- Seritë polinomiale.
- Paraqitja e funksionit si seri.
- Paraqitja e funksionit si seri

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

1. Sipërfaqet midis vijave. Vellimet e trupave. Vëllimi nëpërmjet tubave cilindrike. Puna, mesatarja.
2. Integrimi me pjesë. Integralet trigonometrike. Zëvendësimet trigonometrike. Integrimi i funksioneve racionale me thyesa te pjesshme.
3. Integralet jo të mirefillta. Gjatësia e harkut. Sipërfaqet e rrotullimit.
4. Vijat e përcaktuara nga ekuacionet parametrike. Kalkulus me vijat parametrike.
5. Numrat kompleks.
6. Koordinatat polare. Sipërfaqet dhe gjatësitë në koordinata polare.
7. Prerjet konike. Prerjet konike në koordinata polare.
8. Vargjet dhe seritë.
9. Testi i integralit dhe parashikimi i shumave të serive.
10. Kriteri i krahasimit. Seritë alternative.
11. Konvergjenca absolute, testi i raportit dhe testi i rrënjës.
12. Strategji për kriteret e serive.
13. Seritë polinomiale.
14. Paraqitja e funksionit si seri.
15. Paraqitja e funksionit si seri

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- Kalkulus, T. Shaska, N. Pjerro
- Calculus, James Stewart (botimi i gjashte)

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35%

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 40-100%

Studenti, që rezulton me pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhe për të cilën do të testohet, nuk do te futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do te ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:

N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin “MAT 155”.

Telefonatat në numrin personal fiks apo cellular te pedagogut te lendes nuk janë të përshtatëshme: do t’ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t’ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin “MAT 155” Urgjent” n.q.s problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentet jane te lutur te mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: MAT 155. Përpara se studentet të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentet jane te lutur te mos drejtojnë nërpermjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla eshte mire tu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:

Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe pirja e duhanit në auditor.

SYLLABUS MAT 285 Ekuacione Diferenciale 1

Pedagogu: MSc. Artion KASHURI

Semestri Pranverë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex / 2 sem /

Kredite: 8

Objektivat e lëndës:

Një studim i plotë i ekuacioneve diferenciale duke nisur me ekuacionet me variabla të ndashëm, homogjenë dhe ata të gradës së parë. Më pas studiohen disa tipe karakteristikë ekuacionesh diferenciale si dhe ekuacionet e gradës së dytë. Trajtohen metodat bazë siç janë, metoda e koeficientëve të pacaktuar dhe metoda e variacionit të parametrave. Në fund trajtohet transformimi i Laplasit.

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

- Modelet e ekuacioneve diferenciale dhe problemi Koshi
- Ekuacionet me variabla të ndashëm, homogjenë me koeficientë linearë
- Ekuacionet lineare, Bernuli dhe Klero
- Metoda për zgjidhjen e ekuacioneve ekzakte dhe faktori i integrimit
- Ekuacionet lineare homogjenë të gradës së dytë me koeficientë konstantë
- Ekuacionet johomogjenë të gradës së dytë
- Metoda e koeficientëve të pacaktuar
- Parimi i superpozimit
- Metoda e variacionit të parametrave
- Ekuacioni Koshi-Euler
- Transformimi i Laplasit
- Teoremat e translacionit
- Transformimi invers i Laplasit
- Teorema e konvolucionit
- Zgjidhja e sistemeve lineare me anë të transformimit të Laplasit

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

1. Modelet e ekuacioneve diferenciale dhe problemi Koshi
2. Ekuacionet me variabla të ndashëm, homogjenë me koeficientë linearë
3. Ekuacionet lineare, Bernuli dhe Klero
4. Metoda për zgjidhjen e ekuacioneve ekzakte dhe faktori i integrimit
5. Ekuacionet lineare homogjenë të gradës së dytë me koeficientë konstantë
6. Ekuacionet johomogjenë të gradës së dytë
7. Metoda e koeficientëve të pacaktuar
8. Parimi i superpozimit
9. Metoda e variacionit të parametrave
10. Ekuacioni Koshi-Euler
11. Transformimi i Laplasit
12. Teoremat e translacionit
13. Transformimi invers i Laplasit
14. Teorema e konvolucionit
15. Zgjidhja e sistemeve lineare me anë të transformimit të Laplasit

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- "Fundamentals of differential equations", Eighth edition, R. Kent Nagle, Edëard B. Saff, Arthur David Snider.
- Cikël leksionesh, Artion Kashuri.

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	**Vlerësimi në përqindje**
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30 %
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%

Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesshme, detyrave si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:

N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin "MAT 285".

Telefonatat në numrin personal fiks apo celular të pedagogut të lëndës nuk janë të përshtatshme: do t'ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t'ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin "MAT 285" Urgjent" n.q.s problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentët janë të lutur të mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: MAT 285. Përpara se studentët të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentët janë të lutur të mos drejtojnë nërpërmjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla është mirë t'iu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftimet do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:

Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS FIZ 151_ FIZIKE 1
Pedagogu: Silvana Miço

Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex / 2 sem

Kredite: 8

Objektivat e lëndës:
Ky kurs ofrohet për studentët e shkencave dhe të inxhinierisë dhe përfshin studimin e mekanikës dhe termodinamikës. Temat që do të trajtohen përfshijnë idetë njutoniane të hapësirës, kohës dhe lëvizjes, ligjet e ruajtjes në mekanikë, lëkundjet dhe valët, fluidet, teorinë kinetike të gazeve dhe parimet e termodinamikës. Ky kurs synon përvetësimin e koncepteve dhe parimeve bazë si dhe aftësimin e studentëve në zgjidhjen e problemave; motivimin e studentëve përmes shembujve praktikë nga jeta e përditshme që demonstrojnë rolin e fizikës në disiplina të tjera si inxhinieria, matematika, kimia, biologjia dhe informatika; pajisjen e studentëve me një kornizë konceptuale për ristrukturimin e njohurive të tyre, duke pretenduar kalimin e tyre gradualisht nga niveli i njohjes në nivelin e studimit të fizikës. Ky kurs përmbush kërkesat e formimit të përgjithshëm universitar për studentët e shkencave dhe të inxhinierisë.

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Temat që do të trajtohen në leksione janë:

1. Shkenca. Metoda shkencore. Teoritë fizike dhe struktura e tyre. Vektorët dhe veprimet me vektorë. Matjet. Njësitë bazë në SI. Strategjia e zgjidhjes së problemave
2. Sistemi i referimit dhe koordinatat. Zhvendosja dhe shpejtësia. Nxitimi. Ekuacionet e lëvizjes . Rënia e lirë. Lëvizja dy dimensionale
3. Lëvizja e lakuar. Vektorët e zhvendosjes, shpejtësisë dhe nxitimit. Lëvizja me nxitim konstant. Lëvizja e trupit të hedhur në një kënd me horizontin. Pika materiale në lëvizje rrethore. Inercia. Ligji i parë i Njutonit. Koncepti i forcës dhe i masës.
4. Ligji i dytë i Njutonit. Forca e rëndesës dhe pesha. Ligji i tretë i Njutonit. Aplikime. Detyra themelore e mekanikës klasike. Lëvizja nën veprimin e një force konstante, forcës së fërkimit dhe forcës rezistente që varet nga shpejtësia
5. Dinamika e lëvizjes së lakuar. Forcat që varen nga distance. Puna e një force konstante. Puna e kryer nga një forcë e ndryshueshme. Energjia kinetike. Teorema e energjisë kinetike. Fuqia
6. Energjia potenciale. Forcat konservative dhe jokonservative. Energjia potenciale gravitacionale, e elasticitetit dhe elektrike. Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike. Grafiku i energjisë dhe ekuilibri i sistemit. **Provim i Pjesshëm 1**
7. Impulsi dhe goditjet. Impulsi linear dhe ligji i ruajtjes së impulsit. Goditjet elastike dhe joelastike njëdimensionale. Goditjet dy dhe tre dimensionale. Qendra e masës. Goditjet elastike qendrore në lidhje me qendrën e masës. Zhvendosja këndore. Shpejtësia këndore. Nxitimi këndor. Kinematika e lëvizjes rrotulluese.
8. Momenti i inercisë. Njehsimi i momentit të inercisë. Momenti rrotullues. Ligji themelor i dinamikës së lëvizjes rrotulluese. Kushtet e ekuilibrit të trupit të ngurtë. Puna dhe energjia në lëvizjen rrotulluese. Momenti i sasisë së lëvizjes. Lëkundjet e thjeshta harmonike. Shndërrimet energjitike në lëkundjet e thjeshta harmonike.
9. Sistemet lëkundëse. Lëkundjet që shuhen. Lëkundjet e detyruara dhe rezonanca . Valët mekanike. Përhapja e valës dhe karakteristikat e saj. Ekuacioni dhe energjia e vales. Pasqyrimi, përthyerja dhe shpërhapja e valës. Difraksioni. Valët zanore. Efekti Dopler
10. Mbivendosja dhe valët e qendrueshme. Parimi i mbivendosjes. Interferenca e valëve. Valët e qendrueshme në korda dhe shtyllat e ajrit. Rrahjet. Mekanika e fluideve. Trysnia. Tensioni sipërfaqësor. Dinamika e fluideve. Ekuacioni i Bernulit. Rrjedhime. Ligji i Arkimedit
11. **Provim i Pjesshëm 2.** Temperatura dhe ligji zero i temperaturës. Bymimi termik i lëngjeve dhe trupave të ngurtë. Përshkrimi makroskopik i gazit ideal.

12. Teoria kinetike e gazeve. Shpërndarja e molekulave sipas shpejtësive. Energjia në proceset termike dhe parimi i parë i termodinamikës. Nxehtësia dhe energjia e brendshme. Nxehtësia specifike. Puna në proceset termodinamike dhe energjia e brendshme
13. Parimi i parë i termodinamikës. Zbatime të parimit të pare. Nxehtësitë specifike molare të gazit ideal. Proceset adiabatike. Nxehtesia latente dhe shndërrimet fazore
14. Mekanizmat e shkëmbimit të energjisë në proceset termike. Motori termik, entropia dhe parimi i dytë i termodinamikës. Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme. Cikli Karno
15. Pompa termike dhe frigoriferi. Aplikime. Entropia. **Provim Final**

Tema II: Temat që do të trajtohen në seminare janë:

1. Vektorët dhe veprimet me vektorë. Njësitë bazë në SI. Strategjia e zgjidhjes së problemave
2. Kinematika. Ekuacionet e lëvizjes. Rënia e lirë. Lëvizja dy dimensionale
3. Lëvizja me nxitim konstant. Lëvizja e trupit të hedhur në një kënd me horizontin
4. Ligji i parë i Njutonit. Ligji i dytë i Njutonit. Forca e rëndesës dhe pesha. Ligji i tretë i Njutonit. Aplikime. Zgjidhja e detyrës themelore të mekanikës klasike
5. Puna e një force konstante. Puna e kryer nga një forcë e ndryshueshme. Energjia kinetike. Teorema e energjisë kinetike. Energjia potenciale. Ligji i ruajtjes së energjisë mekanike
6. Impulsi dhe goditjet. Impulsi linear dhe ligji i ruajtjes së impulsit. Kinematika e lëvizjes rrotulluese
7. Impulsi linear dhe ligji i ruajtjes se impulsit.Goditjet nje dhe dy-dimensionale. Kinematika e levizjes rrotulluese
8. Njehsimi i momentit të inercisë. Ligji themelor i dinamikës së lëvizjes rrotulluese. Lëkundjet e thjeshta harmonike Shndërrimet energjitike në lëkundjet e thjeshta harmonike
9. Sistemet lëkundëse. Valët mekanike. Pasqyrimi, përthyerja dhe shpërhapja e valës. Difraksioni. Efekti Dopler
10. Interferenca e valëve. Valët e qendrueshme në korda dhe shtyllat e ajrit. Mekanika e fluideve. Ekuacioni i Bernulit. Rrjedhime.
11. Përshkrimi makroskopik i gazit ideal
12. Teoria kinetike e gazeve. Nxehtësia dhe energjia e brendshme. Puna në proceset termodinamike dhe energjia e brendshme
13. Parimi i parë i termodinamikës. Zbatime të parimit të pare. Nxehtësitë specifike molare të gazit ideal
14. Parimi i dytë i termodinamikës. Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme. Cikli Karno Zbatime
15. Entropia. Ushtrime per perseritje

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	**Vlerësimi në përqindje**
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%.

Piket (%)	MOSFREKUENTIM Seminare < 75%	< 40	40-49	50-59	60-69	70-79	80-89	90-100
Nota	M	4	5	6	7	8	9	10

Studenti, që rezulton me më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesshme, detyrave si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:

Në qoftë se ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin "FIZ151".

Telefonatat në numrin personal fiks apo celular të pedagogut të lëndës nuk janë të përshtatshme: do t'ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t'ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin "FIZ151_Urgjent" në qoftë se problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentët janë të lutur të mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: FIZ151. Përpara se studentët të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentët janë të lutur të mos drejtojnë nëpërmjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla është mirë tu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftime që do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:

Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS FIZ 152 Fizikë 2

Pedagogu:

Semestri Pranverë 2015
Ngarkesa javore: 3 lex / 2 sem

Kredite: 8

Objektivat e lendes:
Trajtimi i njohurive baze te analizes matematike, algjebres lineare si dhe te matematikes financiare si dhe aplikime te thjeshta te tyre ne ekonomi. Problematika e shqyrtuar do te kete te beje me ekuacionet lineare, jolineare, perqindjet dhe llogaritja e interesit, derivati, integrali i funksionit, vargjet dhe serite, matricat dhe sistemet e ekuacioneve lineare.

Përmbajtja e lëndës:

Temat e Leksioneve

1. Vetitë e ngarkesave elektrike. Përçuesit dhe izolatorët. Ligji i Kulonit. Fusha elektrike. Vijat e fushës elektrike. Lëvizja e grimcave të ngarkuara në një fushë elektrike të njëtrajtshme . Fluksi elektrik. Teorema e Gausit
2. Zbatime të ligjit të Gausit për një shpërndarje simetrike të ngarkesave. Përcjellësit në ekuilibër elektrostatik. Potenciali elektrik. Diferenca e potencialeve. Ndryshimi i potencialit në një fushë elektrike të njëtrajtshme. Potenciali elektrik dhe energjia potenciale. Lidhja e fushës elektrike me potencialin elektrik.
3. Potenciali elektrik për një shpërndarje te vazhduar ngarkesash. Potenciali elektrik i një përcjellësi të ngarkuar. Kapaciteti. Lidhja e kondensatorëve. Energjia e kondensatoreve të ngarkuar. Kondensatorët me dielektrikë.
4. Rryma elektrike. Rezistenca dhe ligji i Omit. Superpërcjellësit. Energjia dhe fuqia elektrike. Burimet e fem. Lidhja e rezistencave në seri dhe paralel. Ligjet e Kirkofit. Qarku RC.
5. Fusha magnetike. Induksioni i fushës magnetike dhe forca magnetike.Lëvizja e një grimce të ngarkuar në një fushë magnetike të njëtrajtshme.Veprimi i forcës magnetike mbi përcjellësit me rrymë. Momenti rrotullues në një kontur me rrymë. ërcjellësit me rrymë. Momenti rrotullues në një kontur me rrymë. Ligji Bio-Savart. Bashkëveprimi i dy përcjellësave paralele me rrymë.
6. Ligji i Amperit. Fusha magnetike e një solenoidi. Ligji i Faradeit i induksionit. Aplikime të ligjit të Faradeit. F.e.m e induktuar. Ligji i Lencit. Fusha elektrike e induktuar. Gjeneratorët. Autoinduksioni. Energjia e fushës magnetike .
7. Valët elektromagnetike dhe ekuacionet e Maksuellit. Shpejtësia e valës elektromagnetike. Zbulimi i Herzit. Karakteristikat e valëve elektromagnetike. Spektri i valëve elektromagnetike. Ngjyrat. Natyra e dritës. Modeli i rrezes dritore në optikën gjeometrike. Pasqyrimi i valëve.
8. Përthyerja e valëve. Dispersioni i dritës dhe prizmi. Parimi i Hygensit. Pasqyrimi i plotë i brendshëm. Fibrat optike. Shëmbëllimet e formuara nga pasqyrat e rrafshëta. Shëmbëllimet e formuara nga pasqyrat sferike.
9. Shëmbëllimet e formuara nga përthyerja. Lentet e holla. Eksperimenti i Jungut me dy carje. Interferenca me valët e dritës. Ndryshimi i fazës gjatë pasqyrimit. Interferenca në shtresat e holla.
10. Tablloja e difraksionit. Rezolucioni i një çarjeje të vetme dhe hapjeve rrethore. Rrjeta e difraksionit. Difraksioni i rrezeve X. Hapësira dhe koha në mekanikën klasike. Parimi i relativitetit i Galileit. Eteri dhe shpejtësia e dritës. Eksperimenti i Majkelson- Morlit.
11. Teoria speciale e relativitetit. Rrjedhime të postulateve të Ajnshtajnit. Transformimet e Lorentz-it. Dinamika relativiste.
12. Hipoteza e Plankut. Efekti fotolektrik**.** Efekti Kompton.
13. Fotonet dhe valët elektromagnetike. Hipoteza e De Brojlit. Valët lëndore si valë probabiliteti.
14. Parimi i papërcaktueshmërisë së Hajzenbergut. Gjëndja e elektronit në mekanikën kuantike. Ekuacioni i Shrodingerit.
15. Modeli kunto-mekanik i atomit. Përmbledhje.

Temat e Seminareve

1. Ligji i Kulonit. Intensiteti i fushes. Ligji i Gaussit

2. Potenciali elektrik.Energjia potenciale
3. Kondensatorët. Lidhja e tyre në qark. Energjia e grumbulluar në kondesatorët e ngarkuar.
4. Rryma elektrike. Ligji i Omit. Energjia dhe fuqia elektrike. Ligjet e Kirkofit.
5. Induksioni i fushës magnetike dhe forca magnetike. Lëvizja e një grimce të ngarkuar në një fushë magnetike të njëtrajtshme. Ligji i Amperit.
6. Induksioni elektromagnetik. Ligji i Faradeit.
7. Valët elektromagnetike dhe ekuacionet e Maksuellit. Modeli i rrezes dritore në optikën gjeometrike. Pasqyrimi i vaëve.
8. Përthyerja e valëve. Parimi i Hygensit. Pasqyrimi i plotë i brendshëm. Shëmbëllimet e formuara nga pasqyrat e rrafshëta. Shëmbëllimet e formuara nga pasqyrat sferike.
9. Shëmbëllimet e formuara nga përthyerja. Lentet e holla. Interferenca me valët e dritës. Interferenca në shtresat e holla.
10. Difraksioni. Rrjeta e difraksionit. Difraksioni i rrezeve X.Teoria speciale e relativitetit. Rrjedhime të postulateve të Ajnshtajnit.Transformimet e Lorentzit.
11. Dinamika relativiste.
12. Hipoteza e Plankut. Efekti fotolektrik. Efekti Kompton.
13. Hipoteza e De Brojlit. Valët lëndore si valë probabiliteti.
14. Parimi i papercaktueshmerisë së Hajzenbergut. Gjëndja e elektronit në mekanikën kuantike.
15. Ekuacioni i Shrodingerit. Modeli kuntomekanik i atomit.

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- "Hyrje në Fizikë VOL2", J. Mandili, S. Mico,
- "Ushtrime dhe problema të fizikës moderne", J.Mandili, S.Mico, E Myftaraj, V.Tahiri.

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	**Vlerësimi në përqindje**
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30 %
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%

Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhen që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do te futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:

Lenda do te vleresohet mbi bazen e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimi final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do te ripërsëriten provimet, për asnje motiv. Nese ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:

N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin "FIZ 152".

Telefonatat në numrin personal fiks apo celular të pedagogut të lëndës nuk janë të përshtatshme: do t'ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t'ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin "FIZ 152" Urgjent" n.q.s problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentët janë të lutur të mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: FIZ 370 Përpara se studentet të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentët janë të lutur të mos drejtojnë nërpërmjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla është mirë tu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:

Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS Kim 143 Kimi e përgjithshme

Pedagogu: Prof.As.Dr. Petrit Kotori

Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex/2sem / 0 lab

Kredite: 8

Objektivat e lëndës:

Lënda e Kimisë së Përgjitheshme synon që t'u japë studentëve të Fakultettit të Shkencave Teknike njohuri bazë mbi lëndën, elementët dhe substancat kimike. Gjatë leksioneve dhe seminareve bëhet një rishikim më i avancuar i njohurive të marra në Shkollën e Mesme të Përgjitheshme në lëndën e Kimisë, kurse për ata studentë që vijnë nga Shkollat e Mesme Profesionale synohen të jepen që në fillim dhe njohuritë bazë të Kimisë së Përgjitheshme.

Ky program synon të japë një formim të përgjithshëm për të interpretuar fenomenet kimike dhe për të thelluar njohuritë me karakter kimik që mund t'u paraqiten gjatë viteve të studimit dhe në aktivitetin e tyre profesional. Në program janë përfshirë:

Historiku i Kimisë si shkencë. Teoria atomike e Daltonit. Formulat kimike.Nxjerrja e formulave kimike.**Stekiometria**.Barazimet kimike. Barazimet termokimike. Ligji i Hessit. Energjitë e lidhjeve.**Ndërtimi i atomit.** Elektroni. Protoni. Neutroni. Spektrat atomike. Numri atomik dhe ligji periodik. Struktura elektronike e elementëve. Tipet e elementëve.**Vetitë e atomeve**. Përmasat atomike. Energjitë e jonizimit. Afritë elektronike. **Lidhja jonike**. **Lidhja kovalente.** Strukturat e Lwisit. Elektronegativiteti. **Gjeometria e molekulave.**Orbitalet hibride. Orbitalet molekulare. **Gazet**. Ligjet e gazeve.Teoria kinetike e gazeve. Përftimi i ligjit të gazit ideal nga teoria kinetike. Gazet reale. **Lëngjet dhe trupat e ngurtë.** Forcat e tërheqjes ndërmolekulare. Lidhja hidrogjenore. Lëngëzimi i gazeve. Diagramat fazore. Llojet e trupave të ngurtë kristalore **Tretësirat.** Natyra e tretësirave. Procesi i tretjes. Përqendrimi i tretësirave.Tretësirat e elektroliteve.**Reaksionet në tretësira ujore.** Reaksionet e këmbimit. Reaksionet redoks.**Kinetika** Shpejtësia e reaksioneve kimike. Mekanizmi i reaksioneve. Kataliza. **Ekuilibri kimik**. Parimi Le-Shatelie.Acidet dhe bazat konceptet për to. **Ekuilibrat jonike.** Elektrolitet e dobët.Produkti i tretshmërisë.**Termodinamika**. Parimi i parë i termodinamikës. Entalpia. Parimi i dytë i termodinamikës.Entropia. Entropite absolute.Energjia e lirë e Gibssit.**Elektrokimia.**. Elektroliza. Stekiometria e elektrolizës. Elementet galvanike. Korrozioni. Klasifikimi i korrozionit. **Metalet** Lidhja metalike. Teoria e zonave.Gjysmë përcjellësit.**Kimia Bërthamore.**

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

1. Hisoriku i Kimisë. Stekiometria Përbërja në përqindje e komponimeve.
2. Stekiometria e reaksioneve në tretësiraTermokimia.Entalpite e formimit. Energjitë e lidhjeve.
3. Ndërtimi i atomit. Rrezatimi elektromagnetik.. Mekanika valore Numrat kuantike.
4. Mbushja e orbitaleve dhe rregulli i Hundit. Vetitë e atomeve.Lidhja jonike.
5. Lidhja kovalente Rezonanca. Kalimi ndërmjet lidhjes jonike dhe kovalente Gjeometria e molekulave
6. Orbitalet hibride . Gazet. Teoria kinetike e gazeve
7. Lëngjet dhe trupat e ngurtë. Avullimi.
8. Trysnia e avullit e një trupi të ngurtëLlojet e trupave të ngurtë kristalore Tretësirat.
9. Trysnia e avullit të tretësirave. Reaksionet në tretësira ujore. Kinetika.
10. Mekanizmi i reaksioneve. Ekuilibri kimik. Acidet dhe bazat.
11. Ekuilibrat jonike. Produkti i tretshmërisë. Termodinamika.
12. Energjia e lirë e Gibssit. Elektrokimia. . Elementet galvanike Forca elektromotore.
13. Ndryshimi i energjisë së lirë të Gibssit dhe forca elektromotore. Korrozioni i hekurit.
14. Metalet Metalet e grupit I-Adhe II-A. Metalet e grupit te III-A dhe IV-A. Metalet Kalimtare
15. Jo metalet Vetitë e jometaleve të grupit të III-A IV-A. V-A Vetitë e elementeve të grupit te VI-A. Gazet e plogëta. Kimia bërthamore.

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

1. Stekiometria kimike.Barazimet kimike.Rendimenti i reaksioneve.
2. Llogaritjet që bazohen në barazimet kimikeBarazimet termokimike. Llogaritja e entalpisë së reaksionit.
3. Energjitë e lidhjes kimike. Ligji i Hessit.Konfigurimi elektronik i elementeve.
4. Numrat kuantike.Lidhja jonike. Energjia e rrjetes.
5. Lidhja kovalente.Komponimet kovalente. Strukturat e Lwisit.Lidhjet me karakter të ndërmjetëm. Elektronegativiteti.
6. Teoria SHCESHV. Orbitalet hibride. Orbitalet molekulare. Gazet.Ligjet e thjeshta të gazeve. Ligji i gazit ideal.
7. Stekiometria dhe vëllimet e gazeve. Ligji i Daltonit për trysnitë pjesore. Gazet reale
8. Tretësirat. Përqendrimi i tretësirave. Tretësirat e elektroliteve. Bashkëveprimi ndërmjet joneve në tretesirë.
9. Llogaritja e pikës së vlimit dhe pikës së ngrirjes së tretësiraveReaksionet redoks. Numrat e oksidimit. Barazimi i reaksioneve kimik me metoden e ndryshimit të numrit të oksidimit.
10. Kinetika. Shpejtësia e reaksioneve kimike. Gjetja e rendit të një reaksioniEkuilibri kimik. Konstantet e ekuilibrit kimik.Parimi Le-Shatelie.
11. Ekuilibrat jonike.Caktimi i grades së shpërbashkimit elektrolitik.Llogaritja e pH të tretësirave. Përqendrimi i joneve
12. Produkti i tretshmërisë.Hidroliza e kriprave.Barazimet jonike të reaksioneve të këmbimit.Termodinamika. Entalpia Ligji i parë i termodinamikës.
13. Entropia. Ligji i dytë i temodinamikës. Energjia e lirë e Gibssit.
14. Energjia e lirë e Gibssit dhe ekuilibriElektrokimia. Stekiometria e elektrolizës. Ligjet e Faradeit
15. Potencialet elektrodike. Radha e potencielve të metaleve.Potencialet elektrodike dhe ekuilibri.

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- Charles Mortimer KIMIA 1-1,1-2. Botim Shblu botim i ribotim vitit 2003. ISBN 99927-0-140-4
- E. Luzi, E. Mullaj, R.Totoni Kimia e Përgjitheshme dhe Inorganike. (Tekst për Degët Inxhinjerike.) Ribotim Tiranë 2007 ISBN 99437774041
- Henry F. Holtzclav, Jr. William R. Robinson. GENERAL CHEMISTRY Eigth Edition 1998 ISBN 0-669 12861-9
- Joseph D. DeLeo Fundamentals of Chemistry 1998. ISBN 0-673-16591-4
- Mihal Prifti Probleme të Kimisë së përgjithshme. Shblu Tiranë.

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	**Vlerësimi në përqindje**
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%

Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket cdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.

Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Komunikimi

Ushtrimet e detyrave të shtëpisë si dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klasë dhe/ose në adresën zyrtare tëUniversitetit "Ismail Qemali" të Vlorës në internet:http://www.**univlora.edu.al**.ose në adresën elektronike të pedagogut.

Kodi i ndershmërisë

Studentët inkurajohen të punojnë edhe në grupe për ushtrimet e detyrave. Nuk lejohen kopjimet nga njëri-tjetri në provime dhe për detyrën e kursit, detyrat e shtëpisë, etj, e cila do të mbrohet individualisht. Thyerja e këtij rregulli do të shoqërohet me masa ndëshkimore që shkojnë deri në përjashtim nga universiteti.

Rregulla të detyrueshme në kurs

Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe pirja e duhanit në auditor.

Detyrimet e studentit për lëndën:

Studentët në këtë kurs duhet të lexojnë, të realizojnëdetyrat do të kontrollohen rregullisht dhe në rast se ju neglizhoni dhe nuk i bëni në kohë, nuk do të merrni vlerësimin mbarëvajtjes simestrale. Detyrat e shtëpisë do të vlerësohen jo vetëm si sasi por edhe nga cilësia e zgjidhjes së tyre. Frekuentimi i seminareve detyrohet deri ne 75% të orëve. Numri i mungesave mbi 25%ju përjashton nga pjesmarrja në provim.

SYLLABUS MEK 222 Mekanikë Inxhinierike

Pedagogu: Prof.As.Dr. Luljeta Gusha

Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex / 2 sem

Kredite: 8

Objektivat e lëndës:
Të aftesojë studentet të precizojnë dhe vizualizojnë problermet që lidhen me Mekanikes Inxhinierike, Statikën dhe Dinamikën. Zhvillimi i principeve të mekanikës dhe aplikimeve të saj, të cilat shprehen në menyrë rigoroze nëpermjet matematikes. Ligji i pare i Njutonit shpreh princ ipin e ekuilibrit të forcave, i cili është dhe çëeshtja kryesore me të cilën merret Statika. Ky ligj është konsekuencë e ligjit të dytë të Njutonit i cili diskutohet në Dinamikë.

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

1. Ç `është mekanika, koncepte dhe principet kryesore.
2. Statika e pikës materiale. Forcat në plan.
3. Trupi i ngurtë Sistemet ekujvalente të forcave. Ekujlibri i trupit të ngurtë.
4. Forcat e shpërndara: centroida dhe qendra e gravitetit.
5. Analiza e strukturave. Kapriatat.
6. Forcat e shpërndara, momentet e inercisë.
7. Metoda e punës virtuale.
8. Kinematiak e pikës materiale, Lëvizja relative e thjeshtë, llogaritje të komponentëve karteziane, trajektorale dhe cilindrike të shpejtesisë dhe nxitimit.
9. Dinamika e pikës materiale, parimi D`Alembert dhe ligji i dytë i Njytonit në koordinata karteziane, cilindrike dhe trajektorale.
10. Kinematika e trupit të ngurte, levizjet e trupit të ngurtë, rrotullimi rreth një aksi dhe rreth një pike, teorema e Chasle, derivatet e një vektori për referenca relative.
11. Kinetika e lëvizjes plane të trupit të ngurtë, ekuacionet e përgjithshme, trupi i ngurtë simetrikë, rrokullisës rrëshqitës.
12. Metoda punë energji, ekuacioni punë energji për pikën materiale dhe trupin e ngurtë, forcat konservative dhe ruajtja e energjisë mekanike.
13. Metodat e impuls-momentit, ekuacioni i impuls –momentit linear për piken materiale dhe i impuls –momentit këndor për trupin e ngurtë, impakti levizja satelitore.
14. Dinamika e trupit të ngurte në levizje hapësinore, ekuacionet e levizjes hapësinore të përgjitheshme të trupit të ngurtë, ekuacionet Euler, fenomeni xhiroskopik.
15. Mekanika e vibrimeve, lëkundjet e lira me dhe pa amortizim, sistemet oshilatore me shumë shkallë lirie.

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

1. Ushtrime mbi statikën e pikës materiale, forcat në plan.
2. Ushtrime mbi sistemet ekujvalente të forcave.
3. Ushtrime mbi ekujlibrin e trupit te ngurtë.
4. Ushtrime mbi ekujlibrin e trupit te ngurtë.
5. Ushtrime mbi forcat e shpërndara: centroidat dhe qëndra e gravitetit.
6. Ushtrime mbi Analizën e strukturave. Kapriatat.
7. Dhenia e detyrës së kursit. Tre ushtrime mbi statikën dhe dinamikën.

8. Ushtrime mbi forcat e shpërndara; momentet e inercisë.
9. Ushtrime mbi metodat e punës virtuale.
10. Ushtrime mbi kinematikën e pikës materiale.
11. Ushtrime mbi Dinamikën e pikës materiale, parimi D`Alembert dhe ligji i dytë i Njytonit
12. Ushtrime mbi kinematikën e trupit të ngurtë.
13. Ushtrime mbi metodën punë energji.
14. Ushtrim mbi metodën e impuls momentit.
15. Dorëzimi dhe mbrojtja e detyrës së kursit.

